



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance*

KKRF - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar  
KSFI - Kosovski Savet za Financijko Izveštavanje  
KCFR - Kosovo Financial Reporting Council

UDHEZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 01/2014 , KRITERET PËR  
NJOHJEN E SHOQATAVE PROFESIONALE TË  
KONTABILITETIT/AUDITIMIT

Në mbështetje të nenit 26 të Ligji Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar nxjerr këtë

UDHEZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 01/2014 , KRITERET PËR NJOHJEN E SHOQATAVE  
PROFESIONALE TË KONTABILITETIT/AUDITIMIT

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i kriterëve për njohjen e Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për licencimin dhe funksionimin e të gjitha Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit.

**Neni 3**

**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

**1.1. Shoqatë e aprovuar profesionale e kontabilitetit** - shoqatë profesionale e kontabilitetit e njohur nga Këshilli në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Urdhëresë.

**1.2. FNK ( IFAK)-** Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.

**1.3. BSNK (IASB)** - Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

**1.4. BSNAS (IAASB)** - Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Shërbimeve të Sigurisë i FNK-së.

**1.5. BSNE (IAESB)** - Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Edukimit i FNK.

**1.6. SNRF (IFRS)** - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## 1.7. BSKSP (IPSASB) - Bordi mbi Standardet e Kontabilitetit të Sektorit Publik i FNK.

### Neni 4

#### Kriteret e përgjithshme për njohje

Kushtet të cilat duhet të plotësohen nga një shoqatë profesionale me qëllim të licencimit dhe funksionimit të shoqatave profesionale të kontabilitetit, duhet të kenë demonstruar kapacitetin për të përmbushur kërkesat të cilat rrjedhin nga Deklaratat e Obligimeve të Anëtarëve (DOA/SMO).

Një organizatë e cila dëshiron të bëhet shoqatë e aprovuar profesionale e kontabilitetit duhet të plotësojë kriteret në vijim:

1. Të jetë organizatë joqeveritare e themeluar sipas Ligjit Nr.04/L-057 për Lirinë e Asociimit në O.J.Q.
2. Të sigurohet se veprohet në pajtueshmëri me Kodin e Sjelljes Profesionale dhe Kodin e Etikës të FNK-së.
3. Themeluesit e shoqatës duhet të jenë me profesion nga fusha e: kontabilitetit, auditimit, financave, dhe të jenë me eksperiencë dhe renome/reputacion të mirë në lëminë e financave.
4. Të demonstrojë kapacitetin dhe të përmbush kërkesat e DOA (SMO) Deklaratave të Obligimeve të Anëtarëve të FNK-së dhe atë:
  - 4.1. Shoqata duhet të ketë qëllimin e definuar duke shërbyer interesin publik dhe të siguroj përkrahje të vazhdueshme nga grupe të interesit
  - 4.2. Shoqata duhet të ketë strukturë organizative adekuate e cila do të i mundësonte mbarëvajtjen e vazhdueshme të kualitetit të punës. Duhet të prezantohen të nominuarit në të gjithë strukturën organizative, si dhe kontratat e punës së tyre, apo një deklaratë zotuese me të cilën dëshmohet që kandidati do të punësohet me orar të plotë në shoqatë, pas licencimit të shoqatës nga KKRF-ja.
  - 4.3. Të prezantohet statuti, strategjia dhe plani i biznesit.
  - 4.4. Shoqata duhet të prezantoj burimet financiare dhe sigurimin e burimeve financiare, të cilat do të i mundësojnë qëndrueshmërinë e vazhdueshme financiare.

4.5. Duhet të prezantohen politikat dhe procedurat e komiteteve dhe bordit në kuadër të shoqatës.

4.6. Shoqata duhet të dëshmoj aftësi të qëndrueshmërisë operative, me aftësi të vazhdimësisë duke siguruar stafin adekuat për menaxhimin e shoqatës dhe ligjëruesit të cliët duhet të kenë kontrata aktive me shoqatën.

4.7. Duhet të sigurohet literatura adekuate e cila do të shërbej për ligjërime, përderisa literatura duhet të jetë në harmoni me plan programin e shoqatës, dhe të jetë në harmoni me trendët e fundit zhvillimore në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit si dhe fushave të tjera relevante të caktuara sipas direktivës evropiane nr. 8. dhe kërkesave të parapara sipas standardeve ndërkombëtare të edukimit.

4.8. Duhet të prezantohen kredencialet e përgatitësve dhe disenjuesve të programit të ligjërimit dhe të ligjëruesve.

4.9. Duhet të specifikohen kompetencat të cilat do të zhvillohen përmes plan programit të dizenuar të shoqatës, në mënyrë të shkruar dhe grafike. Duke përfshirë mënyrën e ligjërimit si dhe mekanizmat të cilët do të mundësojnë azhurnimin e vazhdueshëm të plan programit konform zhvillimeve në ambientin e jashtëm, përkatësisht në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.

4.10. Shoqata duhet të ketë struktura të brendshme për përkrahje të vazhdueshme të anëtarësisë.

4.11. Shoqata duhet të ketë proces të definuar të licencimit të anëtarëve.

4.12. Shoqata duhet të prezantoj një plan real për përmbushjen e DOA-ve(SMO), po që se nuk janë të përmbushura të gjitha.

4.13. Shoqata duhet të prezantoj planin e angazhimit dhe apo strategjinë për anëtarësimin e plotë në FNK.

4.14. Në mënyrë që plotësimi i kushteve për licencim të shoqatave të jetë në harmoni me kriteret e parapara nga FNK, shoqatat potenciale për licencim duhet të i referohen udhëzimit për Themelimin e Shoqatave Profesionale të Publikuara nga FNK.

## **Neni 5**

### **Përbushja e DOA- ve (SMO-ve) Deklaratave të Obligimeve të Anëtarëve**

#### **1. DOA 1 (SMO 1) Sigurimi i Cilësisë**

- 1.1 DOA 1 (SMO 1) duhet të aplikohet nga organizatat anëtare të FNK-së në programin e rishikimit të sigurisë së kualitetit për anëtarët e saj të cilët kryejnë angazhime të caktuara për auditim të pasqyrave financiare. SMO 1 aplikohet për organizatat anëtare të cilat e kryejnë këtë program në emër të tyre, në emër të profesionit ose në emër të qeverisë, rregullatorëve ose agjencive tjera, ose nëse ky program kryhet nga një organizatë tjetër.
- 1.2 Njëkohësisht, shoqata ka obligim të drejtpërdrejtë ta ketë të dokumentuar strategjinë duke përfshirë mënyrën e promovimit të kontrollit të cilësisë, tek anëtarët e saj mbi përbushjen/harmonizimin me Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1;
- 1.3 Në fushën e auditimit, planin, politikat, procedurat dhe strukturën organizative për sigurimin e cilësisë;
- 1.4 Sigurimi i cilësisë duhet të përfshihet në të gjitha sferat e aktiviteteve të shoqatës, literatura, mësimdhënia, testimet e kandidatëve, monitorimi i zhvillimit të vazhdueshëm të anëtarësisë, kualiteti i punës së anëtarëve të saj në fushën e auditimit, rishikimeve apo dhe shërbimeve të tjera të ofruara nga anëtarësia në tregun e vendit;
- 1.5 Njëherazi shoqata duhet të ketë planin mbi ngritjen e vetëdijes dhe informimit të anëtarësisë mbi rëndësinë dhe obligimet e tyre drejt mbrojtjes së kualitetit të cilësisë.

## **Neni 6**

### **DOA2 (SMO2) Standardet ndërkombëtare të edukimit për kontabilist profesional**

Shoqata ka obligim/përgjegjësi të përbushë të gjitha standardet ndërkombëtare të edukimit 1 deri 8.

#### **1. Standardi 1. Kushtet parakualifikuese të programit të edukimit për kontabilistët profesional**

- 1.1 Shoqata duhet t'i ketë të definuara kushtet para kualifikuese për kandidatët e saj potencial.

1.2 Kushtet para kualifikuese të cilat kandidatët duhet t'i kenë janë: diplomë universitare në fushën e ekonomisë.

1.3 Varësisht nga kushtet para kualifikuese duhet të disenjohet edhe programi edukimit të shoqatës në mënyrë që të arrihet niveli i duhur profesional.

1.4 Programet universitare mund të pranohen sipas statusit. Njohja dhe vlerësimi i programeve të kualifikimeve mund të fokusohet në përmbajtje dhe aspekte të tjera të kualitetit.

## **2.Standardi 2. Përmbajtja e programit të edukimit për kontabilistët**

**2.1** Fushat kryesore të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e programit të edukimit janë:

- 2.1.1 Njohuri në fushën e kontabilitetit dhe financave;
- 2.1.2 Kontabiliteti financiar dhe raportimi;
- 2.1.3 Kontabiliteti i kostos dhe kontrolli;
- 2.1.4 Tatimet;
- 2.1.5 Ligji komercial;
- 2.1.6 Auditimi dhe shërbimet tjera të dhënjes së sigurisë;
- 2.1.7 Financat dhe menaxhimi financiar;
- 2.1.8 Etika dhe vlerat profesionale.

**2.2.** Struktura organizative dhe njohuritë mbi biznesin

- 2.2.1 Ekonomi;
- 2.2.2 Ambienti i biznesit;
- 2.2.3 Qeverisja korporative;
- 2.2.4 Etika në biznes;
- 2.2.5 Tregjet financiare;
- 2.2.6 Metodat Kuntifikuese;
- 2.2.7 Organizimet strukturore;
- 2.2.8 Menaxhimi dhe vendimmarrja strategjike;
- 2.2.9 Marketing;
- 2.2.10 Biznesi ndërkombëtar dhe globalizimi.

**2.3** Njohuri të teknologjisë informative

- 2.3.1 Njohuri të përgjithshme të TI-së;
- 2.3.2 Kompetenca të kontrollit të TI-së;

2.3.3 Kompetenca të shfrytëzimit të TI-së

2.3.4 Njëri nga apo një përzierje të kompetencave të rolit të menaxherëve, vlerësuesve apo disenjatorëve të TI-së.

### **3. Standardi 3. Edukimi Profesional dhe i Përgjithshëm**

3.1 Aftësitë të cilat duhet t'i ketë një kontabilist profesional janë :

3.1.1 Aftësitë intelektuale;

3.1.2 Aftësitë teknike dhe funksionale;

3.1.3 Aftësitë personale;

3.1.4 Aftësi të komunikimit dhe aftësi ndër personale;

3.1.5 Aftësi të organizimit dhe menaxhimit të biznesit.

### **4. Standardi 4 Vlerat Profesionale dhe Etika**

4.1 Programi i edukimit të shoqatës duhet të ketë përmbajtje e cila do të kërkonte zotim nga profesionistët ndaj:

4.1.1 Interesit publik dhe ndjeshmërisë ndaj përgjegjësisë shoqërore;

4.1.2 Zhvillim dhe ngritje (mësim) të vazhdueshme;

4.1.3 Besueshmëri, përgjegjësi, saktësi, mirësjellje, respekt, dhe

4.1.4 Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve.

### **5. Standardi 5 Eksperienca praktike**

5.1 Është e rregulluar me Ligjin për Kontabilitet dhe Raportim Financiar.

### **6. Standardi 6. Vlerësimi i Aftësive Profesionale**

6.1 Standardi përshkruan kërkesën për vlerësimin final të aftësive të kandidatëve para kualifikimit.

6.2 Vlerësimi final i aftësive normalisht është pjesë shtesë krahas kualifikimeve akademike dhe është mbi nivelin e të diplomuarit nga fakulteti (sipas Deklaratës së Bolonjës, "Undegraduate"). Testimi duhet të bëhet duke u mbështetur në njohurit teorike si dhe aplikimin praktik të njohurive.

6.3 Proces ky i cili duhet të jetë i dokumentuar, i besueshëm dhe valid, duke përfshirë testimin e njohurive, aftësive, vlerave të ndryshme profesionale si dhe etikën profesionale. Konsideratë të veçantë duhet t'i kushtohet kredibilitetit dhe besueshmërisë së procesit të vlerësimit.

## **7. Standardi 7. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)**

7.1 Shoqata duhet të disenjojë programin e anëtarësisë duke ofruar dhe kërkuar zhvillimin e vazhdueshëm të anëtarëve të saj. Në këtë formë do të mundësoj azhurnimin e njohurive të anëtarëve duke kushtëzuar atë me anëtarësimin në shoqatë. ZHVP-ja duhet të jetë e dokumentuar.

7.2 Shoqata duhet të ketë programin e monitorimit dhe kontrollit të ZHVP-së të anëtarëve të saj, e cila parasheh minimumin e kërkuar të orëve që duhet të plotësohen dhe dokumentohen nga anëtarët, përderisa ZHVP, duhet të jetë i matshëm dhe i verifikueshëm.

## **8. Standardi 8. Kompetencat e kërkuara nga Auditorët**

8.1 Standardi definton kërkesat e njohurive të cilat duhet t'i ketë kandidati, vlerat etike eksperiencia praktike për të arritur nivelin e auditorit. Fushë kjo e adresuar bazuar në Ligjin për Kontabilitet dhe Raportim Financiar.

8.2 Standardi nuk parasheh përmbushje të kritereve të cilat tanimë janë të adresuara nga ligjet në fuqi.

### **Neni 7**

#### **DOA3 (SMO 3) Standardet Ndërkombëtare dhe Publikime tjera të publikuara nga IAASB**

1 Obligohen shoqatat të implementojnë dhe adoptojnë Standardet Ndërkombëtare të publikuara nga IAASB.

1.1 Implementimi i standardeve ndërkombëtarë nënkupton procesin e ngritjes së njohurive, duke ofruar edukim dhe trajnim relevant, apo edhe implementimi i aktiviteteve të tjera të cilat do të mundësojnë dhe promovojnë kuptimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare.

### **Neni 8**

#### **DOA4 (SMO4) Kodi i Etikës i FNK-se për Kontabilistët e Çertifikuar**

1 Shoqatat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ta kenë Kodin e Etikës i cili do të jetë i harmonizuar me kodin e etikës së IESB (Bordë Nderkombetar i Etikës për Kontabilistët)

2. Njëherazi shoqata duhet të ketë strukturë organizative e cila do të mundësojë jetësimin apo implementimin e kodit të etikës. Promovimin e Kodit të etikës në kuadër të anëtarësisë së saj, monitorimin e vazhdueshëm, si dhe masat disiplinore për shkelje të kodit të etikës.

#### **Neni 9**

##### **DOA5 (SMO 5) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik**

1. Shoqatat obligohen që në kuadër të plan programit të tyre të përfshihen dhe të promovohen standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik të publikuara nga IPSASB.

#### **Neni 10**

##### **DOA6 (SMO 6) Disiplina dhe Hetimet**

1. Shoqatat duhet të identifikojnë dhe të ndërmarrin masa për themelimin e një sistemi efektiv dhe efikas mbi disiplinën e anëtarësisë së saj. Të gjithë anëtarët duhet të jenë të njoftuar me kodin e etikës dhe standardeve të tjera profesionale të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Etikës për Kontabilistët dhe rregullat tjera aplikative në fuqi të implementuara me ligj. Po ashtu anëtarët e shoqatës duhet të jenë të njoftuar me konsekuencat e mos përmbajtjes së kodit të etikës, standardeve , rregullave etj.
2. Shoqata obligohet të themelojë strukturë organizative për mbikëqyrjen e disiplinës dhe hetimeve. Njëherazi shoqatat obligohen të kenë politika dhe procedura mbi mbikëqyrjen e disiplinës dhe procedurat hetimore.

#### **Neni 11**

##### **Shkelje të kodit të etikës përbëjnë secila dhe të gjitha:**

###### **1. Aktiviteti Kriminal**

- 1.1 Akte apo mosveprime të cilat do të diskreditojnë profesionin;
- 1.2 Shkelje të standardeve profesionale duke përfshirë shkeljet e kodit të etikës;
- 1.3 Neglizhencë profesionale;

1.4 Një numër i rasteve më pak serioze të neglizhencës profesionale të cilat në formë të gjithmbarshme prezantojnë jo përshtatshmëri për të ushtruar profesionin;

1.5 Kualitet të dobët të punës;

1.6 Shoqatat mund të përfshijnë edhe raste të tjera të cilat konsiderohen që janë shkelje të kodit apo sjellje të këqija.

## 2. Procesi Disiplinor

2.1 Shoqatat janë të obliguara të themelojnë strukturë organizative siç është:

2.2 Komisioni Disiplinor, dhe Komisioni i veçantë për hetim.

2.3 Komisioni për hetim është përgjegjës të inicioj raste të hetimit dhe të prezantojë rastet e shkeljes pran komisionit për disiplinë.

2.4 Anëtarësia e komisioneve të lartë përmendura duhet të jetë e balancuar në mes të anëtarëve me njohuri profesionale dhe anëtarëve me njohuri mbi ambientin e jashtëm. Asnjë person nuk mund të jetë anëtarë në të dy komisionet.

2.5 Shoqatat duhet të përgatitin udhëzimin mbi principet e implementimit të masave ndëshkuese në harmoni me shkeljet e bëra. Në këtë mënyrë do të mundësohet që masat disiplinore janë proporcionale me nivelin e seriozitetit të shkeljes së bërë dhe minimumi i nevojshëm për të arritur qëllimin. Në këtë mënyrë do të mundësohet konsistencë në implementimin e masave disiplinore

## 3. Masat Disiplinore

3.1 Qortim;

3.2 Ndëshkim/pagesë e kostos, shpenzimeve;

3.3 Humbja apo ndalesa e ushtrimit të praktikës së punës;

3.4 Humbja e titullit profesional;

3.5 Suspendim nga anëtarësia;

3.6 Përrjashtim nga anëtarësia.

### Neni 12

#### **DOA7 (SMO7) Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

1. Shoqatat janë të obliguara që në kuadër të plan programit të tyre të promovojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, duke edukuar anëtarësinë përmes ligjëratave dhe trajnimeve të veçanta lidhur me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Po ashtu shoqata duhet të marrë masa që në mënyrë të vazhdueshme anëtarësia e saj të jetë e informuar dhe e azhurnuar lidhur me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

### Neni 13

#### Mbikëqyrja dhe monitorimi

Mbikëqyrja e zbatimit të standardeve dhe procedurave bëhet së paku një herë në pesë (5) vite apo edhe më shpesh nëse KKRF-ja përcakton këtë.

Këtë mbikëqyrje duhet ta bëjë:

Një kontabilist profesionist, anëtar i një shoqate profesionale, anëtar i FNK-së.

Një shoqatë profesionale e cila është anëtare e FNK- së.

### Neni 14

#### Shoqatat ekzistuese

Obligohen shoqatat ekzistuese të cilat operojnë në Kosovë që të kompletojnë dhe harmonizojnë programet dhe rregullat e tyre konform këtij udhëzimi administrativ dhe të paraqesin këtë dokumentacion para Këshillit, jo më vonë se me datë 31.12.2014, në mënyrë që KKRF-ja ti njeh si shoqata profesionale.

### Neni 15

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit.

### Neni 16

Ky Udhëzim Administrativ e shfuqizon Udhëzimin Administrativ Nr.2012/05.

Kryesuesi i Këshillit

Gem Maloku

Prishtinë Dt. 14. 07. 2014